

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“BUSHI & PARTNERS” sh.p.k

Tiranë, më 02/02/2021

NENI 1

Shoqëria Tregtare **“BUSHI & PARTNERS”** sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“BUSHI & PARTNERS” sh.p.k**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

1. Zyrë avokatie e cila ofron shërbime ligjore dhe konsulenca të ndryshme;
2. Ofrimi i shërbimeve ligjore për individët, personat fizikë dhe juridikë shqiptar dhe të huaj;
3. Përfaqësimi i personave fizik, juridik, shqiptar ose të huaj në institucione të ndryshme publike e private si dhe përfaqësimi në të gjitha shkallët e gjyqësorit.;
4. Konsulencë financiare e fiskale, përfshirë edhe hartimin e pasqyrave financiare, etj.;
5. Kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji për profesionin e avokatit dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 4

Selia e Shoqërisë


Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:

“Rruga e Barrikadave, K2, N17, Tiranë, Shqipëri”

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë. Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortaku i shoqërisë vijon si më poshtë:



z. Andi BUSHI, shtetas shqiptar, lindur më datë 21/07/1992, në Fier, Shqipëri, shtetas Shqiptar madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës nr. BF4420262 dhe nr. J20721087T personal, në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, i barabartë me 1 kuotë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortaku Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Andi BUSHI**, lindur më 21/07/1992 në Fier, Shqipëri, shtetas Shqiptar, identifikuar nëpërmjet Pasaportës me nr. BF4420262 dhe nr. J20721087T personal, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.


Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.



NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqrisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.


NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Andi **BUSHI**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Andi Bushi', is written over a horizontal line. Below the signature is a large, stylized, looping flourish.